



Pranuar me: Primljeno: 22. 09 20 22		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-016-51026		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
MUNICIPALITY OF LIPJAN  
SKUPŠTINA LIPLJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

## NJOFTIM

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës, autoriteti kompetent i Komunës së Lipjanit pas zhvillimit të procedurës së hapur dhe konkurruese, me datën 20 shtator 2022 ka lidhur kontratë me kompaninë fituese për ofrimin e përkrahjes profesionale për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). Këto shërbime do të ofrohen për Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si organ përgjegjës për hartimin e PZHK.

PZHK është akti më i lartë i planifikimit hapësinor në nivel të pushtetit lokal, një plan strategjik multi-sektorial me të cilin përcaktohen caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Ky plan do të zbatohet për periudhën e ardhshme tetë (8) vjeçare, kurse pritet të realizohet në periudhën prej afër 14 muajve.

Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal do të jetë i hapur për publikun, ku përfshihen subjekte të caktuara institucionale, të shoqërisë civile dhe palë të tjera me interes. Pjesë e rëndësishme janë edhe konsultimet publike me qytetarët e Komunës së Lipjanit. Konsultimet publike do të mbahen për tridhjetë (30) ditë me radhë.

Autoritetet kompetente të Komunës së Lipjanit në vazhdimësi do të mbajnë të informuar opinionin lipjanas për procesin e hartimit të PZHK dhe veçanërisht për periudhën e konsultimeve publike me qytetarë.

Lipjan, 22 shtator 2022

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit